



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Vitina

## PROCESVERBAL

### NGA SEANCA E II E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Seancën e ftoi dhe e kryesoi kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, z.Naim Pira . Seanca është mbajtur në Sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 27.02.2015 (e premte) në ora 10,<sup>00</sup>. Në seancë prezantuan 25 anëtarë të Kuvendit, munguan dy këshilltar me arsye. Në seancë ishin prezent kryetari i Komunës z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu, drejtorët e Drejtorive, përgjegjësja ligjore, përfaqësuesi i OSBE-së, organizatat joqeveritare dhe mediat e shkruara dhe elektronike.

Kryesuesi para se të filloj me punë sipas rendit të ditës i përshëndeti të gjithë të pranishmit, si: Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, Këshilltarët e Kuvendit, Drejtorët e Drejtorive, Përfaqësuesin e OSBE-së, OJQ-të, Mediat etj. Pas numërimit nga sekretaria të këshilltarëve në sallë kryesuesi konstatoi se kemi kuorum dhe mundemi me filluar me punë të seancës së II të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë.

**Kryesuesi:** Para se të kalojmë në miratimin e rendit e ditës, më lejoni tu informoj se në materialin të cilin e keni marr ju keni pas një prezantim të aktivitetit të grupit të gruas, që na ka përcjell kryetarja e grupit jo formal të grave znj.Mirlinda Sadiku, ne falënderojmë për punën që ka bërë, unë nuk po e shoh të arsyeshme që të dal dhe të na informoj, e keni pas si material dhe e keni pa gjithashtu, dëshiroj tu informoj se Kuvendi Komunal në vitin e kaluar ka formuar komitetet konsultative, dhe atë Komitetin për Qytetar në Vendimmarrje, Komitetin me Aftësi të Kufizuara. Këto janë konstituua, të dyja këto komitete kanë zhvilluar aktivitetin e tyre dhe natyrisht kuvendit ja kanë prezantuar punën që kanë bërë vitin e kaluar dhe planin e punës që kanë për këtë vit, para se të kalojmë në miratimin e ditës kisha kërkuar nga sekretaria ti shpërndaj formularët në lidhje me gjendjen e pasurisë, që është obligim dhe duhet të dorëzohen brenda këtij muaji, formularët e plotësuar mund ti dorëzoni në zyrën e sekretarisë së Kuvendit të Komunës së Vitisë. Në seancën e kaluar kemi pasur disa pyetje nga këshilltarët

komunal, z.Bekimi ka parashtruar 2 pyetje, ka kërkuar një raport në lidhje me dy zyre, Zyrën e Bujqësisë dhe Zyrën e Inspeksionit, ne kemi informatë se drejtoritë përkatëse kanë përgatitur një raport dhe ish kanë mirë të shpërndahet nga sekretaria, gjithashtu z.Bekimi ka parashtruar edhe një pyetje për Drejtorinë e Arsimit, në lidhje me migrimin e nxënësve në periudhën e fundit, nëse e kemi drejtorin këtu kishte qenë mirë ta merr fjalën dhe të na përgjigjet.

**z.Qahil Sinani:** Përshëndetje Kryetar, Kryesues, Nënkryetar dhe ju të pranishëm, gjatë kësaj kohe nga shkollat tona janë larguar 272 nxënës, ma së shumti nxënës ka të larguar nga fshatrat e mëdha, ta marrim shembull Pozheranin edhe nga shkollat e mesme këtu në Viti, por nga pak ka gati prej secilit katund, vetëm në Remnik nuk ka asnjë nxënës të larguar dhe në Stubëll asnjë.

**Kryesuesi:** Gjithashtu z.Sameti ka parashtruar një pyetje në lidhje me listën e investimeve kapitale për këtë vit, që e ka aprovuar ky Kuvend, meqë nuk ka qenë në atë seancë kur është aprovuar buxheti, kishte qen mirë nga ana e drejtorit të na jep një informacion se a e ka të gatshme atë listë të investimeve kapitale që ta sjell, pasi është shpërnda e falënderojmë drejtorin. A ka nga ju ndonjë pyetje apo ndonjë propozim, pasi që jemi të pyetjet e ditës, fjala për ju është.

**z.Samet Idrizi:** I nderuari Kryesues, Kryetar, Nënkryetar, Koleg asamblist dhe ju të pranishëm të tjerë, unë kam kërkuar listën e investimeve kapitale për vitin 2015, më duket se nuk të qenka kështu tërësisht e përfunduar, si ku kanë mu bërë investimet saktësisht, nuk kisha mu zgjeruar shumë në lidhje me këtë. Mirëpo, te faqja e parë, ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publike 70 mijë euro vlera e projekteve, është mirë me ditë ku kanë mu shpenzuar këto mjete dhe propozoj që rruga “Dëshmoret e Kombit”, rrugë që shpie te varrezat e dëshmorëve, sepse ajo rrugë ka nevojë për trotuar dhe për ndriçim, edhe ka nevojë edhe për një investim jo shumë të madh në rrjetin e ujësjellësit, unë ju them se kjo rrugë ka pasur ndriçim shumë kohë para luftës dhe tash nuk ka dhe është rrugë shumë e frekuentushme dhe janë mbi 200 a 300 shtëpi që jetojnë në atë rrugë, andaj kërkoj prej kolegëve këtu që ta kenë parasysh në vitin 2015 të përmbyllen këto investime në këtë rrugë.

**z.Sokol Haliti:** Përshëndetje për të gjithë! Të nderuar këshilltar të Kuvendit të Komunës së Vitisë, i nderuari Kryesues, Nënkryetar, Qeveri Komunale, OSBE, medja të shkruara dhe elektronike dhe ju të pranishëm të tjerë që jeni prezent këtu, nuk dëshirova ta lë për më vonë, dëshirova tu përgjigjem menjëherë, se me siguri e keni parë edhe sot, e keni edhe në agjendë, mirëpo, mu dok pak ma e nevojshme me dal unë, ne në këtë kuptim kemi shkuar përpara, sot e keni edhe propozimin për rrugën “Dëshmorët e Kombit” dhe “Lidhjen e Prizrenit”, te dyja përnjëherë për tretuar dhe për ndriçim nuk do të mbesin anash, as tregu, as parkingu te Varrezat e Dëshmorëve, as fusha sportive, në këtë rast e kemi bërë një marrëveshje edhe me “Hidro Moravën”, që edhe rrejtji i ujit të shtrihet, bashkëfinancues në projekt jemi së bashku me DEMOS-in dhe me “Hidro Moravën”, këto tria që i përmende zotëri këshilltar, tash e kemi edhe afatin për nënshkrimin e kontratës me DEMOS-in, ajo do të jetë me 1 prill dhe me 15 maj pritet fillimi i punëve në këto projekte.

**z.Baki Nebiu:** Përshëndetje për të pranishmit! Gjatë këtij muaji që shkoj, nxënësit e Shkollës së Mesme të Vitisë “Kuvendi i Lezhës” një javë nuk kanë mbajtur mësim, për arsye se siç thonë nxënësit janë të informuar për mos funksionimit të nxemjeve, që si pasojë është ujësjellësi i qytetit të Vitisë. Unë i kam disa pyetje për drejtorin e Arsimit, unë e di që nuk është hera e parë që ujësjellësi ka pas dëmtime në Komunën e Vitisë, por asnjëherë procesi mësimi nuk është ndal, andaj kërkoj që të di se për çfarë arsye është ndërprerë mësimi, a ka staf teknik ajo shkollë, edhe sa punëtor teknik ka ajo shkollë, edhe sa duhet ti ketë ajo shkollë. Pika tjetër është, unë sot para jush e kam një vendim të Ministrisë të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinorë, që me urdhër të qeverisë së kaluar është bërë kërkesë për uljen e taksave në pronë për leje të ndërimit, pra ky vendim është i propozuar nga Drejtoria e Urbanizimit në atë kohë dhe që një vit është miratuar, është sjell Komunës së Vitisë dhe komuna nuk e ka proceduar. Unë kërkoj nga kryetari dhe nga drejtori, që në seancën e ardhshme të procedohet kjo pikë dhe të sjellet në kuvend si pikë e rendit të ditës për miratimin e këtij vendimi.

**z.Qahil Sinani:** Së pari tu informoj se nuk është ndërpre mësimi asnjë ditë në gjimnaz, ka pasur prishje të ujit në përgjithësi në Komunën e Vitisë, është bërë një shkurtim i orëve nga 5 min deri 10 minuta për shkak se nxemjës, sepse rrjeti i ujit brenda në shkollë ka qenë i zbrazur nuk ka pas mundësi të mbushet me ujësjellës, prandaj kemi intervenuar në mbrëmje deri vonë dhe 2 mijë litra ujë janë furnizuar dhe është mbush rrjeti i nxemjës dhe asnjë ditë nuk është ndërpre mësimi, kush të ka thënë nuk e di a unë jam ai që përgjigjem për këtë.

**z.Baki Nebiu:** I nderuar pa e marr mirë informatën se shkolla nuk ka pasur mësim unë nuk isha dal këtu me të bërë pyetje ty edhe e kam vëllain në atë shkollë edhe e di që nuk ka pasur mësim ajo shkollë si pasojë e mos ngrohjes së shkollës, edhe unë e di se aty në shkollë nuk ka staf teknik, se me pas staf teknik ish riparuar ajo gjë dhe nuk ish marr vesh hiq, në këtë kohë me ndërpre mësimin për shkaqe të nxemjës unë nuk po kuptoj.

**z.Qahil Sinani:** Nëse po thu ashtu dëshmitar kryesor jam unë se mësim është mbajtur edhe nuk ka humb mësimi, dhe kush të ka than ai nuk është përgjegjës, përgjegjës jemi ne për këtë është drejtori shkollës dhe mund të shkojmë ti kqyrim të gjitha orët janë mbajtur, prandaj mos u merrni me fjalë të rrugëve, por merruni me fjalë zyrtare, staf teknik ka, por shtëpiak nuk ka.

**z.Baki Nebiu:** Kërkoj falje se ndoshta orët janë shënuar në ditar, por procesi mësimor nuk ka vijuar dhe unë drejtorit ja bana një pyetje, sa punëtor të stafit teknik i ka ajo shkollë edhe sa duhet ti ketë.

**z.Sokol Haliti:** Zotëri këshilltar, mund të informohesh edhe me letër zyrtarisht, pyetjet janë legjitime për numrin e punëtorëve në shkollë të mesme, numrin e shtëpiakëve edhe numrin e teknikëve, nuk është ndonjë problem, se e dimë se pas reshjeve kemi krejt komunat edhe ne kemi pasur dëme, njëri prej dëmeve ka qenë prishja e rrjetit të ujësjellësit, “Hidromorava” është përgjegjëse për ujësjellës dhe na e dimë se ajo është regjionale, por komuna e ka mbështet me të gjitha kapacitetet, por në këtë rast shfrytëzoj rastin ta them se edhe “Hidromorava” me të gjithë së bashku i kanë vu kapacitetet në dispozicion me rregulluar sa ma

shpejt ujin dhe si pasoj e zënies së gypit ka pësuar edhe nxemja e shkollës, por i nderuari z.Këshilltar, mësimi nuk është ndërpre, por kanë pasur vështirësi.

**z.Bekim Azizi:** Përshëndetje Kryesues, Kryetar, Nënkyetar dhe ju anëtarë të Kuvendit! Edhe unë po kyçem pak, te nxemja edhe uji janë dy çështje të ndamë, kuptoni atë se jam edhe me profesion i kësaj pune, se nxemja nuk mund mu kanë me e lidhur me qasjen e ujës-jellësit nëse e kanë derdhur ujin, atëherë është dashtë me mbush, mirëpo edhe nëse nuk ka ujë, atëherë duhet mu ndërpre mësimi, se 1 mijë e 500 nxënës nuk guxon me mbajt mësim nëse nuk ka ujë, por është shqetësim i qytetarëve se 1 javë nuk ka pasur ujë, ajo është ma e keqja, por ne i dimë vështirësitë që kanë ndodh, unë dashta mu lidh se raportin që e kam kërkuar që 4 seanca ma kanë sjell Drejtorja e Bujqësisë, nuk shënon dy fjalë se u bërë djegia, vetëm dy fjalë si është bërë, nëse ka mundësi në seancat tjera. E kam kërkuar edhe një raport nga ndihmat momentale nga Zyra e Kryetarit, kisha ngrit edhe një shqetësim tjetër, qeto orët e rrymës që janë vendosur nëpër trotuare është një pengës, është një pasiguri, se na e dimë se para tri jave vetëm ka pëlcit një orë e rrymës në pjesën e rrugës kryesore edhe në pamje edhe në pengesë të qytetarëve edhe në rrezikshmëri nuk janë në vendin e duhur, unë mendoj se duhet të bëjë një plan, komuna të bisedoj me KEDS-in dhe ato duhet të hekën, duke pasur parasysh se edhe ato orë janë jashtë standardëve dhe ministra i ka ndaluar ato orë, unë mëno se duhet të hekën edhe nga trotuaret.

**z.Bislim Bislimaj:** Përshëndetje të pranishëm pjesëmarrës të kësaj seance, më vjen mirë se shifemi prapë pas një kohe relativisht të gjatë, por në këto rrethana që po kalon Kosova dhe gjithë shqiptarët në përgjithësi më vjen mirë që prapë takomi në këto rrethana paka shumë të tensionuara nga ngjarjet e fundit, ngjarje këto që as nuk i kemi dëshiruar e as nuk i kemi nxitur, por politika e bastarduar i ka analizuar në këtë rrugë e ne disa nuk po gjejmë rrugë tjetër dhe nuk dimë se si tu shmangemi dhe ballafaqimi është i pashmangshëm. Unë së pari dëshiroj tu shprehu falënderim për gjithë ata të cilët na kanë bashkndjerë ose janë solidarizuar në forma të ndryshme dhe na kanë mbështet për të realizuar qëllimin, nuk do të kisha pasur dëshirë që ndokush se ngjarjet po i nxisim ne, sepse edhe për një njeri bari delesh është e kjart se serbët me veprimet e tyre anti kushtetuese, anti ligjore dhe anti njerëzore po nxisin dhe po krijojnë situata nënshtruese, përçmuese edhe poshtëruese dhe për këtë çështje nuk do të kisha folur më tepër, sepse na e dimë se veprimet e tyre të poshtra i dimë që 100 e sa vjet. Unë kisha dashtë këtu me cekë se veprimet dhe deklaratat e disa pushtetarëve tanë që merren me protestat edhe demonstratat antiserbe, hipokrizia e tyre shkon aq larg sa që në vend që të kujdesën për pasurin e popullit në ruajtjen e institucioneve, fabrikave, ndërmarrjeve e tjetra nga hajnat, këta i mbështetin këta, në 10 vitet e fundit në botë ndodhën kësi pakënaqësi bile edhe me gjëra ma të vogël se këtu, p.sh.: protestat e amerikanëve për vrasjen e njerëzve me ngjyrë kanë shkaktuar dëme kolosale, Franca para ca vitesh u dogje, thua se e tëra për një ligj kundër pensionit, Greqia djepi i demokracisë që sa vite është duke u përball me protesta e shumë vende të tjera, te ne bëhet bujë se një parlament ngjyroset me ngjyra, një objekti të

qeverisë u thyhen xhamat apo dëmtohen, disa prona apo dyqane, për kundër kësaj nuk protestohet kur shuhen fabrikat e punëtorëve, kur korruptohet jo vetëm qeveritarët, por edhe sindikatat e punëtorëve, kur vidhet shteti, kur vidhen dhomat e dëshmimeve, kur vidhen pasaportat e qytetarëve, kur plaçkiten ndërmarrjet e shumë sende të tjera, kjo hipokrizi e lartcekur, të cilët po e bëjnë politikanët lakmitar, ata se me kamngulje dëshirojnë ta mbajnë pushtetin dhe nuk lëshojnë rrugë, kjo injorancë e këtyre politikanëve dhe nënçmimi që i bëjnë këtij populli, duke lejuar kamata të larta të bankave më të larta në botë, duke i rrjep me çmime të shtrenjta me të shtrenjtat në Evropë, gjatë kohës kur unë mungova sidomos në ditët e para të paraburgimit dëgjova reagime dhe prononcime shumë negative edhe të shtrembruara nga ana e shumë politikanëve në lidhje me ngjarjet, dikush thotë se nuk duhet ta vëmë veshin, por se shpejti u tregua se ato ishin të arsyeshme dhe të drejta u desh që sheshi Skenderbeut të përgjakët edhe një herë nga djemtë e rijë, të cilët kërkonin me të drejtë largimin e Jabllanoviçit nga qeveria, kishe fyer nënat e dëshmorëve, krejt këto janë pasoja që ne sot po i vuajmë kështu, ndodhi edhe tek ne, u rrahën deputetët e popullit, që përfaqësojnë opozitën, u rrahën edhe u torturuan gjeneralët e UÇK-së, kur dola në liri kuptova se në një prononcim të feisbukut edhe një koleg i yni u prononcua në mënyrë të ngjashme sikurse Jabllanoviçi, i quajti protestuesit bisha, egërsira, mua ndoshta nuk do të më kishte ardhur rënd kjo, kur ta dëgjoj ku për këso shprehjesh nuk prononcohet subjekti i tij ose kryetar i atij subjekti, që së paku të distancohet nga prononcimet e tilla, kjo e ka një shpjegim, ata dhe ky subjekt ka rrëshqitur në ujërat e trubëllta, ku nuk mund të shohë se si jeton populli që i zgjodhi ta përfaqësojnë atë, por këta të vënë pas lakmisë së pushtetit, mundohen se edhe proceset që qojnë përpara demokracinë ta pengojnë, kjo është shumë e dëmshme, aq më parë kur ky vetë edhe tërë familja për të njëjtat arsye kishte vuajtur disa vite me largim të tërë familjes, edhe ky pati fatin që të fitoj vota dhe të rehabilitohet, por populli vallë a do të ketë fat të tillë. Këtë heshtje të kryetarit dhe të kryesisë së saj, me premtimet e bëra se fusha e sportit do të ndërtohet në vitin 2014, edhe se me plan ka qenë në vitin 2015, u premtua se komuna do të hapet së shpejti, duke i tejkaluar të gjitha mosmarrëveshjet, dolën u fotografuan njëjtë edhe shkollën e mesme, u tha që do të zhvillohet bujqësia dhe do të tejkalohen problemet dhe vështirësitë në fushën e Vitisë, hymë në lumin “Morava”, me boldozher eksportuan dheun në emër të sanimit të shtratit dhe në funde vërshimi i parë i dëmtoj të gjitha fushat, u bë bujë e madhe se do të rregullohet rrjedha e epërme e lumit, për tu shndërruar në një shëtitore, u bë projekti me foto të bukura, por e gjitha kjo mbeti se kishte qenë ëndërr dhe përfundoj me pastrimin e lumit, e kam një porosi për të gjithë ju, hapni sytë dhe mos atë që nuk mund të realizoni, dhe mos mendoni ti qitni hi syve të popullit se ai ju vëzhgon, nëse nuk mundeni me realizuar ato premtime kërkoni ndihmë ose hiqni dorë. Të jesh pushtetar nuk do të thotë se je i pa prekshëm dhe meritat dhe dënimet është populli që do ti gjykoj. 28 Janari i vitit 2015 do të hap një faqe të re në historinë e Kosovës martire, në këtë ditë ka nisë një proces i tillë, i cili nuk mund të ndalet, filloi demokracia popullore e njomur me gjakun e të djemve të ri, faliminderit që keni pasur

respektin me më dëgjuar, nuk po e ndie vetën shumë të liruar se prej një burgu të vogël në një burg të madh, na atje i kemi pasur do dhoma të vetmisë, kush ka qenë i padisiplinuar shkojke në vetmi, zine se un kam qenë në vetmi e ju keni qenë me një burg të madh, dhe këtë burg nuk e kemi merituar ne shqiptarët, janë dy faktor të cilët kanë ndikuar në këtë burg të madh: faktori ndërkombëtar dhe faktori vendor. Ata dy i kanë përgjegjësitë për këto, na nuk kemi faj, na kërkojmë liri sikur ata që kërkojnë liri në vendete veta.

**z.Sokol Haliti:** Ju kërkoj falje të gjithë të pranishmëve, por edhe ty në veçanti kryesues që po e udhëheq këtë takim, por megjithatë rendi i ditës është pyetje përgjigje, nëse e keni bërë me vendim dhe tash na këtu po lexojmë deklarata politike, që janë të nivelit shumë ma të lartë, pra janë të nivelit qendror, ne jemi të vegjël si komunë mu merr me kësi far fjalime pompoze, së pari akuzuese në fund lutëse dhe këto dyja nuk shkojnë bashkë, mos të merret Kuvendi i Komunës, i cili vërtet e ka bërë një rehabilitim të tërësishëm, por edhe qeveria komunale së paku të klimës që është admiruese në tërë Kosovën, dhe për këtë kemi marr edhe nota të larta, edhe nga instancat ndërkombëtare, ndërsa tash ulmi edhe merremi me feisbuka, feisbukat edhe rrjeti social po na tregon se nuk janë për ne ende në kohë. Kisha pas dëshirë se Kuvendi i komunës së Vitisë dhe unë dhe qeveria komunale mos të merren me feisbuka, se ne kemi pas fjalë ma të rënda këtu në këtë kuvend 3 a 4 herë, besoj se janë edhe në procese dhe unë i kam tejkualuar për hir të unitetit veprues, nuk ka nevojë me fol për atë që dihet, sepse ajo qa dihet nuk thuhet në politikë, ato janë çështje makropolitike dhe unë mendoj se një person mund me destabilizuar vendin me një fjalë apo me një gurë, atëherë vetëdija shtetërore neve na mungon, nëse dikush kërkon mu a njoh edhe burgun e tanishëm me bërë të burgosur politik është çështje e tij personale, por unë po të them se na jena pa ma shpesh, se e tha në fillim këshilltari jo na jena pa shumë moti, por ti nuk ke qenë prezent dhe jo me fajin tonë, tash nëse është derdh gjak shumë mirë që nuk ka shkua ma tutje dhe mu bërë si në të kaluarën, sepse edhe uniforma është e jona dhe këta djemtë janë tonët dhe kur ta shikosh proporcionin 29 me 150 uniformë e jona e lënduar në mesin e tyre edhe zëvendës komandanti i njësisë speciale, të cilin e kemi bërë gjallotë dhe e kemi dërguar në Turqi për me shëruar dhe bash hiq nuk e kemi bërë namin dhe hiq nuk duhet të lavdëromi, dhe një çështje ju kisha dashtë tu them për çështje që nuk është kompetencë niveli lokal mund të bisedojmë, por bashkërisht të kërkojmë nga niveli qendror të na ndihmon qoftë në magjistrale, unë shpesh po e them, dy sene janë të shenjta, njëra komandantët nuk na nevojiten tash neve, se komandantet janë treguar kur e kanë pasur kohën, respekt për ata që kanë luftuar në atë kohë dhe ishalla vërtet respektohet ata që kanë qenë komandant dhe luftëtar dhe uroj që të jetë ashtu, dhe më vjen shumë mirë që nuk e kam lëshuar asnjë deklaratë në këtë drejtim, por edhe më vjen shumë mirë që nuk kam qenë fare i përzier në këtë kuptim. Kisha dashtë të kalojmë me pikat e rendit të ditës, që mos të kalojmë jashtë programit, qeveria që e udhëheq unë donë me punuar, me procedua me program z.Kryesues, dhe kisha dashtë që të bashkëpunoj edhe me deputetin tonë, se ai dje e bëri një pyetje, por e murrë përgjigjen shpejtë nga ministri, se magjistrallja ka hyr në planifikim buxhetor

mu rregullua dhe mu shtruar, se dje e murr përgjigjen nga ministri, për arsye se ju nuk keni dashtë ti besoni kryetarit. Një ditë pasi ma ka konfirmuar ministri, pas vendimit janë mbjell pishat, ky është veprim që mund mu bërë megjithatë demokratik a sanksionohet me dal me punuar në magjistrale për atë punë janë organet nuk jemi ne për këtë punë, sepse un nuk jam organ, unë jam kryetar komune, por magjistratja do të rregullohet dhe do ta përurojmë bashkë, veç ishalla ato para investohen qysh duhen në projektin e rrugës, përndryshe edhe palestra edhe komuna edhe magjistratja, por edhe “Morava” janë të nivelit qendror , besoj se së bashku do ti arrimë edhe këto projekte te mëdha për komunën tonë, dhe jo të hapim tema që vërtetë janë të pariparueshme dhe të krijojmë përçarje dhe defetizëm në masë. Migrimin e rastit të fundit që ndodhi në Hungari, pas humbjes së vajzës dy vjeçare i shprehu ngushëllime në emër të tuajin anëtarit të kësaj familje, që e kemi këtu në Kuvend z.Negjatit.

**Kryesuesi:** Faliminderit kryetar, tash po procedojmë me rendin e ditës, por para se të kalojmë në rendin e ditës e kemi edhe një propozim vendim, **Propozim vendimi për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2014 në vitin 2015.** Meqenëse ky propozim vendim nuk ka ardhur në KPF, për faktin që ministria e ka lejuar me 25 të këtij muaji, pra para dy dite dhe drejtorja përkatëse na ka pru që sot ta propozojmë para jush, atëherë e hidhi në votim, kush është që të jetë si pikë e shtatë e rendit të ditës edhe kjo pikë, ju lutëm me ngritje dore, konstatoj se me votat e shumicës hynë edhe kjo pikë në rendin ditës.

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e I e rregullt e KKV-së.
2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar- dhjetor 2014.
3. Shqyrtimi i propozim rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Vitisë.
4. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e tregut të gjelbër në Pozheran.
5. Propozim vendimi për dislokimin e tregut të gjelbër në Pozheran.
6. Propozim vendimi për bashkëfinancimin e projektit: Rregullimi i trotuareve.
7. Propozim vendimi për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2014 në vitin 2015.

A ka dikush rreth rendit të ditës, nëse nuk ka e hedhim për miratim, kush është që të miratohet ky rend i ditës, me votat e të gjithë të pranishëmve miratohet rendi i ditës.

Dhe si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e I e rregullt e KKV-së**

Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës, a do ta merr fjalën dikush, atëherë e hedhim në votim për miratim, kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës, me vota unanime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi :

### **2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar- dhjetor 2014**

Ja japim fjalën drejtorit që të na paraqet para jush.

**z.Ibrahim Rama:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne sot para jush ju kemi sjell pasqyrat financiare janar – dhjetor të buxhetit për vitin 2014, ju e keni marr me kohë materialin për pyetje, sugjerime, jam këtu për tu ndihmuar.

**Kryesuesi .** hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës .

**znj.Vjollca Kadolli Halili:** I nderuar kryesues, Kryetar, të nderuar Këshilltar, Drejtor dhe ju të pranishëm! Para se me hy në rendin e ditës, dy drejtorëve të rinj ju kisha uruar suksese në punë, para vetës i kemi pasqyrat financiare, falënderoj njëherë drejtorin për prezantimin, sa i përket të hyrave kemi një rritje në vlerë prej 208 mijë euro si dhe një realizim të planifikimit të të hyrave prej 95. 96 përqind . te shpenzimet buxhetore përsëri kemi një realizim ku shihet se është bërë një planifikim i drejt i shpenzimit të buxhetit i cili është bërë prej 99,14 përqind qka mendoj se duhet të përgëzojmë drejtorin e financave që ka bërë një planifikim dhe një shpenzim të buxhetit të saj , kur jemi te investimet kapitale shihet se kemi edhe një listë ku shihet edhe një nr. I madh i projekteve që janë kryer këtu ma së miri flet edhe shifra prej 2 milion e 400 mijë euro ose shfrytëzimi i buxhetit për investime kapitale 100 përqind , është mirë që drejtori na ka sjell edhe obligimet e vitit 2013 ku kemi bërë edhe një krahasim dhe shofmi edhe obligimet që kanë mbet këtë vite ku shihet se obligime nga viti 2013 janë 173 mijë euro , do të ndalem pak te shpenzimet ku kisha kërkuar nga drejtori mi zbërthyer disa shpenzime psh. Shpenzime shendetësore kemi në vlerë 43 mijë euro shifra është 13 . 430 gjithashtu shifrën 13 .509 kemi pajisje tjera në vlerë 36 mijë euro si dhe shifrën 13 . 630 furnizime mjekësore 47 mijë euro kisha lut nga drejtori mu na zbërthyer se nuk i kam të qartë se ka janë shkuar se është goxha shifër e lart gjithashtu kisha kërkuar një sqarim se këtu kemi një shifër më të ulët për 30 mijë euro të furnizimit me dru pyetja ime është a keni ble këtë vite ma pak dru apo si është puna .

**znj.Majlinda Ostroglava:** Përshëndetje për të gjithë kolegët! Lëvizja Vetëvendosje ka shqyrtuar me vëmendje pasqyrat financiare të periudhës Janar – Dhjetor 2014, ashtu siç kemi thënë edhe më parë, por mendoj se për qytetarët e Vitisë shpenzimet janë matësi ma i mirë i performancës së një qeverie, duke u nisur nga ky raport, pas një shqyrtimi të kujdesshëm, pavarësisht nga përpjekjet e udhëheqjes komunale për një sukses, prapë na del një zhgënjim,



nëse i referohemi dokumentit të aprovuar, buxheti prej 9 milion euro apo 99% i shpenzuar na del në këtë mënyrë; shpenzimet e luksit dhe pa asnjë rezultat për qytetarët, dreka zyrtare gjithsej 25 mijë Euro, d.m.th krahasuar me vitin 2013, se janë 7 mijë euro më pakë, por prapë mendojmë se është një shumë e madhe në sy të qytetarëve, të cilët ballafaqohen me shumë probleme elementare, karburante për vetura 51 mijë e 732 Euro, ndoshta mund të ketë këtu ndonjë arsytim, koleg të nderuar Vitia edhe Kosova nuk ka rrugë për këto shpenzime, shpenzime brenda vendit, besoj se edhe këtu do të ketë ndonjë arsytim, sepse mendojmë se nuk kemi standarde për këto lukse, investimet kapitale i kemi 2 milion, d.m.th cilësi të punës nuk e kemi ashtu qysh duhet, të rrugëve, të ujësjellësit, do të ishte mirë të kemi një shpjegim, se qa nënkuptojmë me pajisje tjera, të cilat janë shpenzuar 36 mijë euro, furnizime për veshmbathje 10 mijë euro, d.m.th ndonjë shpjegim ma konkret. Do të ndalna pakë te arsimiti, pavarësisht investimeve prapë gjendja mbetet e njëjtë, shëndetësia nga raporti shihet se kemi rritje të investimeve, sidomos në shërbime dhe mallra, që na duhet një shpjegim ma konkret, se qytetarët prapë po ballafaqohen me mungesën e barërave më elementare. Bujqësia, sektori i cili më së shumti sjell zhvillim ekonomik dhe u kanë premtuar gjatë gjithë fushatës, prapë siç duket është jashtë vëmendjes në këtë raport, ne dimë që problemet dhe hallet e qytetarëve të Vitisë janë të shumta dhe nuk mund ti zgjedhim me këtë buxhet që kemi, por me një vizion më të qartë besoj se mund të kryem punë më shumë, kjo si periudhë nuk mund të kthehet, por ne si lëvizje i bëjmë thirrje udhëheqjes komunale që të jenë ma të kujdesshëm në shpenzimet e parasë publike, mbështetja e Lëvizjes Vetëvendosje nuk do të mungoj asnjëherë në përmirësimin e këtyre sektorëve.

**z.Ekrem Abazi:** Pasqyrat financiare të Kuvendit Komunal në periudhën Janar – Dhjetor 2014. Po ua filloj te shpenzimet të udhëtimit brenda vendit 30 mijë e 58 Euro, shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit 10 mijë e 632 Euro, nuk janë shumë, por çka ka përfituar komuna jonë me qeto shpenzime, që janë bërë jashtë vendit, shpenzimet e telefonisë fikse 17 mijë e 135 Euro, me të vërtet këto po më dukën shumë, nuk e di sa kushton tash një minutë me fol brenda a jashtë vendit, po kjo po më duket shumë mua, shpenzimet e telefonisë mobile 2477, kush merr mbushje për telefonin mobile, mobile 14936 E, besoj se mobilet vetëm nëse i gjuani se nuk ka nevojë me ble fare, karburante për vetura 51732, ndoshta ka pas nevojë, por prapë mu po më duken shumë, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve 18 mijë e 371 euro, do automjete i keni blerë të reja e mu bërë kaq shumë po më doket shumë, mirëmbajtja e ndërtesave 71740 euro, edhe te kjo është kanë mirë mi cekë cilat ndërtesa janë mirëmbajt, dreka zyrtare 25173 euro, kur ta shikosh në muaj nuk janë shumë 2 mijë euro, nuk janë shumë po rrethanat që jemi na janë shumë, të hyrat buxhetore vetanake të planifikuara dhe të realizuara te do drejtori, planifikimi është bërë i mirë, kurse në do nuk është rritë përqindja as 50%, p.sh.: te Administrata janë planifikuar 96 mijë, janë realizuar 54 mijë ose p.sh.: te Shërbimet Publike janë planifikuar 176 mijë, janë realizuar 210 mijë. Këtu planifikimi dhe të hyrat shumë dallim i madh ose këta se e kanë tejkaluar 210% janë punëtor shumë të mëdhenj, por dallimi mes planifikimit

dhe të realizimit është 95%, që është mirë. KKSB-ja, e pashë në internet, që kish thanë se qytetarët janë të dezinformuar, këtë po e them jashtë rendit të ditës. Jo këshilltarët nuk janë të dezinformuar, por qytetarët tonë kanë ikur për arsye ekonomike, skamje që kanë shumë edhe për shkaqe shëndetësore, p.sh.: ai qytetari i Beguncës për shkaqe të shëndetësisë së fëmijës, e ka pasur të smutë, ka ikur, nuk kanë ikur për qef siç po thonë, edhe numri i nxënësve me krahasuar në nivel vendi në Viti është numri i lartë që e kanë lëshuar vendin.

**z.Samet Idrizi:** Unë kam vërejtur se pasqyrat financiare të 9 mujorit kanë qenë më të specifikuar se fundviti, unë mendoj se kanë qenë dashtë mu nda pak në mënyrë ma decidive për pasqyrat financiare për drejtoritë veç e veç, në mënyrë që ta dimë se qysh janë bërë ndarjet dhe shpenzimet krahas nevojës të drejtorisë dhe prioritetëve, që duhet tu ju jepni të gjitha dikastereve veç e veç, po sidoqoftë unë personalisht kisha dashtë mu kanë pak ma shumë të detajuar në analizë, si që të jetë mua më vjen mirë që ka pasur rritje të hyrave vetanake, prapë kemi disa vërejtje, disa kritika, të cilat unë mendoj që këtë vit që po hymë mu përmirësuar, planifikimi ka qenë i qeverisë së kaluar, tash realizimi është i qeveris së tanishme dhe pak a shumë nuk mund të jemi shumë objektiv në vlerësimin dhe kritikën tonë që japim. Unë ma shumë kisha mu ndalur te disa shpenzime edhe te subvencionet se sanë analizë të detajuar të pasqyrave financiare. Përsëris edhe një herë, kryetari ka qenë i fokusuar ma shumë me zhvillua Drejtorinë e Bujqësisë, por kjo nuk ka ndodh, ju e keni pa vet se më së paku ka pasur subvencionim në Drejtorinë e Bujqësisë, po ashtu edhe plani i planifikuar është realizuar diku 90.14% ma pak se të gjitha drejtorit tjera, unë pak jam i befusuar për këtë, se ka ndodhur tash, veç kisha me ba një krahasim, përkundër respektit dhe punës që ka bërë Kaltrina, unë mendoj se ka qenë drejtoresha ma e angazhuar, ma dinamike, po megjithatë unë nuk mund me pranuar se ma shumë mu shpenzuar në DKRS se në Drejtorinë e Bujqësisë, ma shumë me bërë subvencion për DKRS-në se për Drejtorinë e Bujqësisë ose ka ndodh pasi ka ardhur qeveria e re ma shumë. Për shembull, subvencione në bujqësi janë vetëm 13700 Euro, kurse në DKRS janë 29361 Euro, është një disproporcion, një subvencionim jo real karshi rrethanave dhe qysh na jetojmë. Po ashtu mallra dhe shërbime, na nënkuptojmë kur ti ndanë për atë drejtori me qëllim për mu afruar kushte ma të mira punëtorëve, që mu a bërë një shërbim ma të mirë qytetarëve ose me bërë një zhvillim ma të mirë të asaj drejtorie, kështu që sugjeroj që në vitin 2015 të ndodh e kundërta edhe pse na kemi nevojë për kulturë. Tjetër, subvencione 70 mijë euro nga Zyra e Kryetarit, ta dimë ma saktësisht ku, në cilat fusha, në cilët sektorë saktësisht u ndihmua. besoj se marrim përgjigje këtu brenda seancës, është mirë mi ditë edhe na edhe qytetarët, me ditë kryetari ku ma shumë është fokusuar. Subvencionet në shërbime sociale, është shumë më rëndësi vlera 19680 E, edhe këtu kujt ju kanë dhënë, se ka fjalë ma shumë janë shpërndarë për militant të partisë përkatëse në pushtet, dhe kjo nuk është mirë. Unë mendoj se kryetari ti ketë parasysh njerëzit që janë ma të varfër apo me nevoja ma të mëdha, ti subvencionoj ata pa dallim partie. Shpenzimet e telefonisë fikse, edhe nëse janë të vitit të kaluar, nëse kanë mbetur

të vitit të kaluar, të 2013-ës, mendoj se drejtori nuk i ka specifikuar, janë 17135 euro janë enorme, pasi telefonia fikse kushton ma lirë, unë mendoj se janë shumë dhe pajtoj me parafolësin tim, është mirë me pa kryetari. Shërbime të ndryshme shëndetësore, ne edhe më herët kemi thanë me detajuar ma shumë, nëse p.sh.: këtu ka kontrata me punëtorë me kontrata në vepër, ta dimë që janë me kontrata në vepër edhe krejt në rregull, na tash këtu për shërbime shëndetësore nuk e dimë çka saktësisht janë, a janë punëtorë me kontrata në vepër që i keni marr a janë makineri që i keni marr në shërbim me qira apo janë shërbime të ndryshme, që nuk po e dimë saktësisht, besoj se do të marrim përgjigje, po ashtu pajisje tjera 36 mijë euro, kur bëhet një përmbledhje vjetore ja vlen me ditë çka janë. Furnizime për zyre 72 mijë euro, edhe këtu ke mundë me bërë një sqarim, p.sh.: tonera, letra që pak a shumë unë mendoj se kjo vlerë duhet mu kanë e arsyetuar, por megjithatë një sqarim ma i detajizuar. Mirëmbajtja e ndërtesave 71 mijë ero, edhe këtu një sqarim ma i detajizuar, dreka zyrtare 25 mijë euro, tash karshi 2% mendoj se për mua është në rregull, besoj se nuk ka diçka të keqe. Ka informata se te arsimit pagat e arsimit janë tejkaluar vlerat reale për numrin që e kemi të punëtorëve, ndoshta edhe aty ka punëtorë me kontratë në vepër, që pak jemi dal jashtë numrit të personelit karshi orëve këtu, është mirë më na sqarua drejtori. Isha ndalur pak te Drejtoria e Inspeksionit, nuk ka arritur planin me realizuar mirë, dikun 57.72%, po shpesh po ndodh që po i ndotin rrugët, shumë keq edhe gjuajnë bërlllog vend e pa vend, posaçërisht në rrugën teme, verës më ka ndodhur tri herë kamë thirr në Stacion të Policisë në Viti, nuk më kanë ndihmuar, jam detyruar dy herë me thirr në Gjilan, prej atje i kanë bërë presion Vitisë edhe kanë ardhur policia. Furnizuesi i lëndës djegëse për shkolla, me dru, rrugën teme dy herë e ka bërë ta merr menja që aty është lavruar asfalti, edhe qa është interesant furnizuesi aq kryeneç edhe aq keq u sill, unë kam thirr edhe në Drejtori të Inspeksionit, edhe ata kanë qenë shumë në reagim të ngadalshëm, i kam thirr dy herë Inspeksionin, kanë qenë shumë të dobët. Planifikimi urban edhe mjedisi në rrugën Viti – Kllokot, afër pompës “Faiku Petrol” janë ndërtuar disa shtëpi, kisha dashtë me ditë a janë pajisur me leje a jo, kur dihet se janë ndërtuar në vendin ku është toka ma pjellore, unë i kam parë edhe janë fasaduar masaneje kisha lutë që atë pjesë mos me lejuar mu ndërtua ma shumë shtëpia.

**Kryesuesi:** Faleminderit, po konsideroj se pyetjet që na ke parashtruar ti do ti marrim përgjigje, në fund nga drejtori a donë edhe dikush ta merr fjalën

**z.Bekim Azizi:** Bazuar në raportin një vjeçar që kemi ose ma thjesht bazuar në këtë gjysmë raport që e kemi, është raport shumë i vogël, veç krahasone me 9-mujorin, veç letrat shikoni këtu 14 faqe, atje 30, do me thanë është në gjysmë, janë munduar mi dhanë si të përgjithshme, mirëpo, nuk na kanë dhanë mundësinë me pas një qasje, mu kyq në kode apo me pas pak ma gjanë, mirëpo najë kanë ngushtuar mundësinë që na me pasur qasje, i kam kërkuar disa edhe në komitet që me mi pruar për sot, drejtori me shkrim nuk i ka pruar, unë vetëm një po e them, që në këtë tre mujor janë shpenzuar 70% e mjeteve për investime kapitale, kjo u kanë menjëherë një ngatërresë që ka pasur shumë investime, na e dimë se investimet kapitale që

janë shpenzuar për tre muaj, na e dimë se këtë muajin e fundin 50% u shpenzua, megjithatë kjo është kanë e planifikuar mu krye, për mua është shqetësim se është bërë një nguti shumë e madhe edhe punët nuk janë kryer mirë, nuk ka pasur mbikëqyrje të mirë, që është shqetësim që kemi mu përballur me to. Një shembull, para 10 dite qeto gropa që i mbuluat, që u mbjellën qeto pisha, shikoni sot a është ndonjëra e mbuluar, do me thanë 10 ditë mos me mbulu gropa është shumë e keqe. Te subvencionet, p.sh.: në Drejtorinë e Bujqësisë për 9 muaj janë shpenzuar 4.68%, kanë pas mbetur 35 mijë euro për këta 3 muaj, pra i kërkova për këta 3 muaj qeto 35 mijë euro, po nuk i kanë pruar mi shikuar. Edhe në DKRS 15 mijë e 145 euro i kanë pasur në 3 muajt e fundit pa shpenzuar, do me thanë për subvencione është fjala edhe ato i kërkuam ti shikojmë ka janë shkuar, kemi kërkuar për punëtoret me kontrata mbi vepër që janë, prej cilave kode janë paguar, cilët janë ata punëtorë, sa është numri i tyre edhe sa janë pagur gjatë vitit, ata me na prua një listë, por nuk najë ka prua as ato, po kthena pak p.sh.: vaj për vetura 160 euro, 50 mijë euro shpenzime karburante, po ju them se krejt kerret kini mi prishur se nuk ja keni ndërruar vajin, mendoni pak kerrit privat që i harxhon një mijë ero në vite, ja ndërron 2 herë vajin gjatë vitit.

**z.Daut Xhemajli:** Përshëndetje për gjithë të pranishmit! Unë edhe në komitet e kam thanë, që kjo është një gjendje që ka ndodh, ky buxhet është një buxhet i shpenzuar në vitin 2014, pavarësisht pengesave dhe zhvillimet që kanë qenë në atë vit, unë kam konsideruar se ka qenë një shpenzim i mirë, përkundër asaj se me një formë çdo udhëheqje në fund të vitit i ka shpenzuar buxhetin ma shumë se që është dashtë, domethënë nuk është shpenzuar gradualisht po është shpenzuar në fund të vitit, kjo ka ndodh çdo herë dhe kjo është pasoj e mos funksionimit të gjitha mekanizmave në kuadër të komunës, jo vetëm këtu, por edhe ma tutje. Unë herën e kaluar kam folur pak për vend pune, apo për një defekt që mbulohet nga noteria, këtu nuk e di, por njerëzit kujdestar e interpretojnë atë se unë mund me pas konflikte ose interesa për një person të caktuar, unë mendoj që kur të flasim të flasim parimisht, se kjo komunë për nja 30% merr paga të jashtëligjshme, nuk punon kërkosh, nuk ka përshkrim të vendeve të punës nuk ka harmanizim, ka gradime sipas qefeve edhe nuk harmanizohet vendi i punës me koficientat e pagës. Këtu për kompensim të punëtorëve janë harxhuar nja 6 milion e ma shumë, pra shumica e buxhetit është shpenzuar ma shumë për paga, 2 milion e 500 janë shpenzuar për projekte kapitale, dhe te projektet kapitale unë mendoj se nuk është çështja as e derivateve, as e drekave, as e ndonjë shpenzimi enorm për funksionim të administratës, por thelbi është te ne nëse mendojmë me vu rend me kursy buxhetin e me kursy nga keqpërdorimi aty ku ky buxhet edhe aty janë edhe mundësitë për keqpërdorim, sepse unë ju kam than në komitet, se Zyra e Prokurimit gati është vend ku trafikohet me dokumentacion e firmave tenderuese edhe zyre ku duhet mu kanë përgjegjësia ma e madhe në nivel të komunës, bilem krejt ata persona që duhet me punua aty duhet me bërë edhe betim, ndërsa, aty ka punëtor që punon pa kontratë dhe ka që punon me kontratë mbi vepër. Unë mendoj se ky buxhet duhet të filloj të përmirësohet te përshkrimi i vendeve të punës dhe kërkoj që në faqen e komunës të

njoftohet çdo qytetar, edhe na, për përshkrimin e secilit vend të punës në komunë dhe koficientat e tyre, në mënyrë që ta dinë qytetarët për secilin qytetar që punon në komunë. Nuk është e lehtë kjo, po unë mendoj se kjo qeveri ka kapacitet dhe mundet mi hy këtij procesi edhe me rregullua, pak a shumë këtë proces me qitë në binar, sepse mendoj se defektet janë ma të mëdha te projektet kapitale, unë mendoj që në këtë vit janë mbikëqyr ma mirë, ka qenë një kujdese ma i madhe i udhëheqjes, sidomos për komisione nuk po flas. Te shpenzimi i buxhetit, është thënë se mirëmbajtja e rrugëve e tjera është shpenzuar nja 64 mijë euro, unë mendoj se këtë vite ka qenë një mirëmbajtje e mirë e rrugëve, nuk them për rrugët regjionale, se ne jo vetëm se është dashtë me mbjell pisha, po u dashtë në Budrik , Gërlit edhe në Ramjan mi bllokua dhe mos me lan kanë me hy. Nuk i pash të hyrat e tatimit në pronë, e tjera, por e kam edhe një kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, se thotë pajisje trafiku, janë shpenzuar nja 8 mijë euro afërsisht, unë kam kërkesë që policët e shtrirë të vendosen jo në krejt rrugën po të jenë cik cak në mënyrë që automjetet e njerëzve të mos dëmtohen, po të pengohet shpejtësia e tyre, drejtori mund me pas parasysh ma shumë këtë punë. Nuk e pash te tatimi mbi pronë sa është inkasomi, sa është përçindja, sa janë borxhe, obligime të bartura, sepse ne kemi pasur një raport, se herave të kaluara ka pas një rivlerësim të madh e a ka përmirësim në këtë aspekt, unë mendoj edhe një herë dhe sugjeroj se këto dreka e darka e derivate nëse nuk keni qe me than mos e thuani hiq a mos e përmendni, se një udhëheqje mi harxhua kaq pak pare për këto sene e me mendua se është në funksion të qytetarëve është shumë pak e hiq.

**Kryesuesi: A** donë dikush ta merr fjalën, nëse nuk donë ja kisha dhanë fjalën drejtorit, se u parashtruan një numër i pyetjeve që të na jep informacion rreth tyre.

**z.Ibrahim Rama: Mos** mu përgjigj një nga një të gjitha pyetjeve, se disa kanë qenë të njëjta, po filloj nga disa pyetje që i bëri z.Dauti, të hyrat e tatimit në pronë është substanca themelore që po e bënë të hyrat vetanake, është realizuar mbi 100%, përshkrimi i vendeve të punës dhe mosharmonizimi i koficientave është një problem i trashëguar dhe është duke na përcjell dhe jemi tu bë përpjekje dhe kemi bërë kërkesë drejt për se drejti në ministrin përkatëse, duke filluar nga përshkrimi i vendeve të punës dhe harmonizimi i koficientave, projektet investive, do me thanë shuma ke 2 milion e 500 mijë euro e realizuar, është një shumë krahasuar me të njëjtën kohë të vitit të kaluar është ma e madhe për 650 mijë euro, cilësia qe është ma kryesorja, jem mundu cilësia të jetë në nivelin e duhur, në këtë drejtim kemi bashkëpunuar edhe me kryetarët e këshillave të fshatrave, për mbikëqyrjen e punës, që puna të bëhet ma kualitative. Pasqyrat financiare janë të mangëta, unë si ekonomist me faqe nuk kam mundur me matë cilësinë e pasqyrave financiare apo një buxheti në bazë të faqes apo në bazë të cilësisë dhe tabelave apo në bazë të përshkrimit të komponentëve kryesore, që e përbëjnë një buxhet, apo pasqyrat financiare janë përshkrim i shpenzimit të buxhetit të aprovuar në një kuvend përkatës dhe kursimi/shpenzimi duhet me ndodhë në momentin e planifikimit të buxhetit, kur përgatitet buxheti dhe kur miratohet në kuvend, duhet ti paraqes të gjitha këto, dhe në momentin kur aprovohet të gjitha pozicionet që janë të planifikuara nuk ka me kursye, sepse

është e planifikuar saktë dhe nëse nuk e ke shpenzuar si e ke planifikuar atëherë del jo serioz dhe buxheti del jo i shpenzuar në mënyrë adekuate. E gjitha kjo që ka ndodhur është e buxhetit të aprovuar. Gropat në rrugë, u përgjigj edhe Kryetari, këto rrugë regjionale janë në mbikëqyrjen e Ministrisë të Infrastrukturës, na kemi bërë përpjekje me shkresa që ato rrugë të mirëmbahen ma mirë, tash së fundi e kemi edhe konfirmimin nga ministri se kjo rrugë do të rregullohet së shpejti. Disa prej pyetjeve për shpenzimin e buxhetit, shpenzimet për kodin ekonomik 13, 130, shpenzimet për udhëtimet zyrtare brenda vendit, shuma 30 mijë euro, nga kjo shumë 24 mijë euro janë të vitit 2014, 5900 janë të vitit 2013, pjesën dërmuese të këtij kodi ekonomik e përbën transporti i nxënësve nëpër shkolla. Kodi 13, 140 shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, këto e përbëjnë transportin e disa shoqërive kulturo artistike, që i kemi bërë dhe një pjesë është e stafit të komunës. Shpenzimet e telefonisë fikse, shpenzimet e telefonisë mobile në vlerë prej 2400, po kjo vlerë 1300 janë të këtij viti që e ka kryetari i komunës dhe dy muajt e fundit, edhe një pjesë e qeverisë është furnizuar me mbushje për telefona mobil, kurse 1150 janë të paguara për telefoni mobile për vitin e kaluar. Shërbime të ndryshme shëndetësore 43 mijë, prej kësaj shume 22 mijë janë të vitit 2014, kurse 21 mijë janë borxhe nga viti i kaluar, këtu janë 100% janë shërbime të KARITAS-it, që janë me marrëveshje ndërmjet kryetarit dhe KARITAS-it Zvicerran, kjo është kryesisht shpenzime që i kemi me marrëveshje.

Shërbime kontraktuese tjera 29 mijë; 21 mijë janë të këtij viti, këtu përbëjnë kontratat apo marrëveshjet mbi shërbime të veçanta. Një pyetje ke për kontrata mbi vepër, në vitin 2014 nuk ka kontrata mbi vepër po marrëveshje mbi shërbime të veçanta, dhe kjo shumë e përbën këto kontrata, unë e kamë përgatit listën e këtyre marrëveshjeve, dhe pyetja tjetër ke për subvencione në kulturë dhe në bujqësi, edhe këto pyetje janë që janë bërë në komitet dhe në mbledhjen e ardhshme do ua sjellë.

Mobile janë shpenzuar 14 mijë, këto janë një pjesë e mobileve që janë shfrytëzuar edhe në ambientet e kuvendit komunal dhe nëpër shkolla. Pajisje tjera 36 mijë euro, këto janë prioritet, që i kemi vendosur nëpër disa fshatra dhe në 17 shkolla e kemi vendosur një sistem të filtrave për pastrimin e ujit. Furnizimi i lëndës djegëse me dru, këtu po shihet një kursim në vlerë prej 30 mijë euro. Derivate për vetura, edhe këtu ka kursim. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, edhe këtu ka kursime. Dreka zyrtare, vlera 25 mijë prej kësaj vlere 8310 mijë janë të vitit të kaluar, këtë shumë janë mbi 7 mijë euro për dreka zyrtare për “Flakadanin e Karadakut” dhe subvencionet në DKRS-në, janë shpenzuar 24 mijë e 700 euro për subvencionimin e disa klubeve dhe shoqërive, ku një prej tyre është edhe me vendim të Kuvendit Komunal “Kemajl Azizi në Viti dhe në Bujqësi është shuma 23 mijë 560 euro, është shuma e përfituesve në bujqësi, që kanë përfituar gjatë vitit 2014.

**z.Skender Ahmeti:** Përshëndetje për të gjithë! U bënë disa pyetje direkte apo indirekte, rreth Drejtorisë së Inspeksionit, që bëri z. Sameti, që preki dy probleme, që janë sfidë për Drejtorinë e Inspeksionit, çështjen mbeturinave, me të cilat kemi telashe sidomos që nga marsi e tutje. A të

jepen apo jo lejet e ndërtimit është çështje që është rregullua një plan urban për lejimin e ndërtimeve në këto zona dhe ky plan është miratua para 5 vite dhe ne jemi para aktit të kryer. Problemi ma i madh te na qëndron se të ndërtohet objektet e banimit edhe jashtë këtij plani, dhe ajo që e ka shqetësuar ky deputet më shqetëson edhe mua në aspektin institucional, profesional edhe personal, se edhe vetë jam fermerë, ndërsa çështja e mbeturinave është sfidë tjetër e madhe, për shkak se shumë fshatra nuk i kemi futur në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, edhe në ato fshatra na nuk mund me ndëshkua gjithë fshatin, prandaj shpesh në qeverinë komunale po diskutohet shumë si ta bëjmë një zgjidhje të menaxhimit të këtyre mbeturinave, përshaka se po na sjellin probleme të mëdha. Te çështja e kërkesës, që ju e keni bërë, na besoj që ju kemi përgjigje dhe e kemi dërguar inspeksionin te ju, se ne jemi me përpikmëri me zbatua Ligjin për ruajtjen e ambientit dhe do ta sanksionojmë këtë. Një çështje tjetër që u ngrit, të hyrat në Drejtorinë e Inspeksionit janë pak të ulëta, rrethe 25%, unë them se planifikimi nga viti 2013 për vitin 2014 nuk ka qenë real, se ne kemi bërë përpjekje të vazhdueshme për me rrit këtë përqindje, por nuk kemi mund, për shkak se na kemi pak, zakonisht nga bizneset jo formale, të cilat i detyrojmë që të bëjnë pranimin teknikë të objektit, dhe ato të hyra e rritin pak inkasimin edhe të automjeteve, të taksive edhe të autobusëve, se a janë në rregull apo jo, që këtë çështje për planifikimin për vitin 2015 e kamë ngrit në qeverinë komunale, por fatkeqësisht na ka dalë përqindja pa ndryshime, që e kam biseduar me drejtorin e Financave, por qa është efektive te Drejtoria e Inspeksionit, për vitin 2014, është se ju ka shërbyer të gjitha drejtorive tjera për mi rrit të hyrat e tyre, në këtë rast Drejtorinë e Shërbimeve publike e ka qitë 210%, që kemi sjellur të hyra që nuk kanë inkasuar asnjëherë qeveritë tjera komunale, ne i kemi detyruar operatorët mobil mi pagua taksat edhe shumë biznese tjera.

**z. Samet Idrizi:** Besoni se në rrugën time kanë dal inspeksioni, kanë fol me personin në fjalë, ai e ka pastruar pak, ndërkohë masë dite ai për inati ka shkua me shlipër i ka bërë edhe ma shumë edhe këta nuk e kanë dënuar, por ka rate kur u zanë qytetari duke hudhër bërlllok dhe nuk është dënuar.

**Kryesuesi:** Po konsideroj se apeli juaj është që të vetëdijesohen qytetaret, natyrisht të bashkëpunojmë dhe nëse ka mundësi ta hekim këtë dukuri.

**z.Basri Aliu:** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Mu duk se Sameti e përmendi ndarjen e subvencioneve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe bëri një akuzë në atë mënyrë që po u ndahet militantëve, për ndarjen e subvencioneve është një komision i përbërë prej 3 anëtarëve, në mesin e tyre ka edhe prej partisë së Sametit, që mund me ardh me pa atje dhe e dimë që është një rregullore që i plotëson rregulloret për ndarjen e këtyre subvencioneve, dhe sigurisht ato ndahen për personat që kanë sëmundje të rënda, si ndihmë momentale mu ndihmua dhe atyre me gjendje të rëndë ekonomike, ka edhe prej fshatit tij që janë nda dhe janë të partisë së tij. Se ka e ka marrë këtë informatë nuk e di, por

është i mirëseardhur edhe me shikuar listën a atyre që kanë marr subvencione dhe ti dallojmë cilët janë ata.

**znj.Kaltrina Sylejmani:** I nderuar këshilltar, për kritikën pozitive nga ana juaj për realizimin e buxhetit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ai buxhet është harxhuar ashtu si ka qenë i planifikuar për vitin 2014 dhe njëjtë do të vepohet edhe në vitin 2015 me buxhetin që është aprovuar edhe nga ju si legjislativ, ndërsa sa i përket pyetjes për tre muajt e fundit, për hir të transparencës edhe se raporti i DKRS-së është edhe në veb-sajtin zyrtar të komunës, ku mund të i gjeni të gjitha aktivitetet sa i përket kësaj drejtorie. Sa i përket vendimeve se ku janë nda subvencionet, unë i kam me vete vendimet, si: më 27 Tetor kf “Vllaznia” është subvencionuar me 1500 ero ; më 18 Nëntor, Këshilli i Veprimt Rinor Lokal është subvencionuar me 300 euro, 1 Dhjetor, Shoqata e Artistëve është financuar me 1300 euro: 20 Dhjetor, klubi voleybollit “Vllaznia” është subvencionuar me 1 mijë euro; 11 Dhjetor, shoqëria kulturore artistike “Januz Ramadani” është subvencionuar me 1 mijë euro, dhe me 11 dhjetor SHKA “Kemajl Azizi” i është plotësuar me 1750 euro vendimi për ndarjen e subvencioneve

**z.Bislim Bislimaj:** Po kam dëshirë me ndihmua, sa kam dije, po më duket se nuk po e dimë qa kemi prioritet këtu, a kemi prioritet me zhvillua Komunën e Vitisë apo kemi prioritet me marrë prej banorëve me ngrit taksa. Më pëlqej kryetari i Junikut, se e kish rregulla rrugën për Gjeravicë, ku aty ka aq shumë boronica sa që me kumbaj mundemi me mbledh, plus asaj e kishte ndërtuar fabrikën për përpunimin e frutave të malit, kishte ndërtuar diga për me ujitë tokën bujqësore, qeto janë ato që na duhet mu orientuar për me mundësua që kjo rini mos me ikur jashtë. Na e kemi një pasuri që nuk e ka as Juniku, vetëm duhet të bëhen plane dhe të afrohen ata për me investua.

**z.Hasan Aliu:** Përshëndetje për gjithë të pranishmit! Unë tri çështje që besoj se binë në domenin e kryetarit dhe që u shtruan pyetje në atë adresë, do të bëjë përpjekje, por edhe një 71 mijë euro është pastrimi që bëhet në komunë, në shtëpi të kulturës edhe në qendrën e mjekësisë familjare, prandaj nuk është mirëmbajtje, por është pastrim dhe mos të keqinterpretojmë ato çështje dhe duhet ti kuptojmë ashtu siç janë, megjithatë unë do të ndalna edhe te këshilltarja e VV-së, shumë e zhgënjyer, ne zhgënjimin nuk mund ta hekim, as unë as këta koleg, dhe nëse në këto pasqyra financiare ke qenë shumë e zhgënjyer, unë nuk e di cilat ty mund me ta hekë zhgënjimin edhe mu tu rrit ai disponim për Komunën e Vitisë, gjitha barometrat që i ka ofruar drejtori flasin në drejtim pozitiv, edhe në kursim, edhe në të gjitha aspektet, dhe do të ndalëm pak te çështja që e shtroi Sameti, investimet në bujqësi, edhe ne nuk jemi të kënaqur, por në raport me vitet e kaluara sivjet po lidhna në 4 pozicione, të cilat kryetari ka subvencionuar: 1) në pranverën e hershme, pajisjen e 230 fermerëve me foli najloni; 2) shtrimi i shumë rrugëve fushore nëpër lokalitete; 3) pajisja e 30 fermerëve me makina mjelëse dhe 4) shpërndarja e pulave vojëse në viset malore, prandaj janë kanë 4 që janë realizuar brenda vitit 2014. Edhe një çështje, se e shtroi Dauti shumë me rëndësi, se do të ndalëm aty, përshkrimi i vendeve të punës dhe sistematizimi i vendeve të punës, që e kërkon



ndoshta edhe na si qeveri komunale, ma së paku kemi bërë në këtë drejtim, por deshta tu njoftoj se dje a ka ardhur prej ministrie një model i standartizimit përshkrimeve të vendeve të punës, një lloj moduli, i cili do të jetë i unifikuar për krejt Republikën e Kosovës. Duke ju falënderuar për kontributin e dhënë dhe për arsyen, të gjitha ato kritika që e kanë bazën e vetë, binduni se do të jenë të mirëseardhura në korrigjimin e mëtutjeshëm, po e përfundoj me Sametin, që tha nuk është mirë, po edhe un pajtona se nuk është mirë, po është shumë ma mirë që ka qenë, un besoj se pajtohet edhe Sameti.

**Kryesuesi:** Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, pasi në këtë pikë nuk parashihet të votohet do të kemi një pushim deri ora 13.00.

Vazhdojmë me pjesën e dytë të Kuvendit Komunal të Vitisë, po e shohë se një numër i madh i këshilltarëve nuk janë kthyer, disa me leje disa edhe pa leje, unë tash e tutje nga sekretaria do i kërkoj dy lista të nënshkrimit dhe për bazë për çështje të mëditjes do ti marrë listat, të cilat nënshkruhen në fund, vazhdojmë me rendin e ditës.

Si pik të tretë të rendit të ditës kemi:

### **3. Shqyrtimi i propozim rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Vitisë**

Ju e dini se Kuvendi Komunal në seancën e fundit ka debatuar në lidhje me rregulloren, natyrisht është dal propozimi që të shkohet në debat publik, ju është nënshtruar debatit publik më 16.02.2015, ka qenë një numër i vogël i studentëve, por sido qoftë kanë dhanë edhe ata vërejtjet e tyre, ja jap fjalën drejtorit të arsimit, që ta merr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës .

**z.Qahil Sinani:** Asamblistë të nderuar! Na rregulloren e kemi pas në shikim të parë dhe e kemi pasur në debat publik, ka pas prezent edhe studentë, nuk ka kurfar vërejtje, tash presim nga ju që kjo rregullore ta merr formën e prerë, të miratohet në mënyrë që mos të vonomi që ta shpallim konkursin menjëherë, pasi të kryhet miratimi nga ju dhe formohet një komision për ndarjen e bursave, unë po e jap një mendim për sa të ndahen bursat, por ju jeni që vendosni, presim një herë nga ju çka po propozoni.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor, hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës

**znj.Vjollca Kadolli – Halili:** Ne mendojmë se është një vendim shumë i drejtë për studentë, që të merret vendim për ndarjen e bursave dhe të caktohen kriteret për ta, e di që është punua në këtë drejtim, është mirë që përkrahën gjeneratat e reja, sikur ata të rinj që shpeshherë për shkak të kushteve sociale nuk kanë mundur mi vazhdua studimet, megjithatë unë do të lidhem pak te kriteret dhe do ta japi një propozim, se këtu e kemi nenin 8, pika c, ku thuhet se këtu do të merren parasysh kandidatët që janë regjistruar për herë të parë në fakultet, duhet të kenë dëshminë e suksesit të shkollës së mesme edhe diplomën paraprake, kurse kur dalim te kriteret dhe përparësitë, te neni 9, nuk kemi saktësim se si do të poentohen këta student që janë në

vitin e parë, realisht propozimi jem është konkret, që të bëhet një poentim të paktën për nxënësit që kanë pasur një sukses shembullor, tu bëhet një poentim 15 ose 20 pikë, por është mirë që të vendoset sot, që të mos kemi probleme në të ardhmen, unë mendoj se duhet të merret parasysh suksesi i tyre shkollor.

**z.Baki Nebihu:** Para se me fillua me kërkesat tona, unë do mua bë një vërejtje, kur bëni debat publik ju kisha lut që njoftimet të jenë ma të gjera, jo sikur herën e fundit, se isha prezent edhe vetë pjesëmarrës, ishin vetëm 4 studentë, ta kemi parasysh që para se me bë debat njoftimi të jetë ma i zgjeruar, ne kemi kërkuar si grup i VV-së, që komisioni të jetë prej 5 anëtarëve, komisioni ish rrit, por kërkojmë se dy anëtarë të këtij komisioni të jenë nga opozita. Kërkesa tjetër, neni 9, studenti/ja në lami deficitare vlerësohet me 15 pikë, ne kërkojmë që të cekën këtu në rregullore, cilat janë lëmit deficitare, kërkesa tjetër është cilat janë mundësitë financiare të komunës, d.m.th sa studentë do të përfitojnë prej këtyre bursave dhe sa do të jetë shumta e bursës për studentë. Dhe e fundit, studentët me nevoja të veçanta kërkojmë të kenë një përparësi ma të madhe.

**z.Bekim Azizi:** Duke u nisur nga diskutimi publik, i cili unë mendoj se është i dështuar, sepse në krejt rregulloren që e kemi qua për diskutim një fjalë, shkollor, është hekë dhe numri 3 është bërë 5, kurgja nuk ka tjetër. Pra, diskutimi ka dështuar, por megjithatë unë mendoj se dr.Vjollca, që e lidhë te këta të vitit të parë, sepse edhe studentët të vitit të parë e kanë pasur një afat, dhe mund të ketë ndonjë student që me fat e ka marr 10, dhe mund të konkurroj që ndoshta kish një dështim, atëherë të merret për bazë edhe suksesi që ka pasur ma herët, ti bashkëngjitet qertifikatës së notave. Edhe te çështja e komisionit prej 5 anëtarëve, mirëpo këtu ceket në rregullore: se kryetari e cakton komisionin, mirëpo, megjithatë do të ketë edhe anëtarë të opozitës në këtë komision. Te kriteret zakonisht është një problematik, që na jep mundësi me diskutuar ma vonë, unë mendoj se fëmijët e dëshmorëve dhe personat me aftësi të kufizuar, që janë studenta, ata të kalojnë pa kriteret se nuk janë shumë.

Te çështja e lemive deficitare, tash te rregullorja nuk janë të caktuara nëse i shtim në rregullore, pastaj duhet të ndërrohet çdo vit rregullorja, sepse numri i lëmive deficitare na ndryshon, mirëpo edhe nëse nuk i shtim në rregullore duhet të cekën cilat janë lëmit deficitare, kur bëhet konkursi. Edhe te neni 9, pika b, studenti/ja i cili nuk i ka prindërit, a është fjala që nuk i ka dy prindërit, sepse është mirë të dallohet ajo që nuk e ka një prind, sepse ata që si kanë dy prindit duhet tu jepet hapësirë ma shumë. Fëmijët e veteranëve, invalidëve edhe personave apo viktimave civilëve, ata duhet të poentohen me pikë, te shumta e përgjithshme, nuk e dimë sa është përcaktua, pasi nuk e dimë shumën, është pak problem, por unë kisha menduar, kjo shumë të jetë ma e vogël sesa ka qenë më herët, se më herët ka qenë 500 euro, përshake se e dimë se sivjet çmimet janë përgjysmuar, mendoj se kjo shumë për studentë mjafton edhe 400 euro .

**z.Visar Demiri:** Te neni 3, më bani pak konfuz, se nuk e di a është rregullore për komunën e Vitisë a për Gjakovë, për shkak se në Gjakovë për mu ba qytetar duhet mi pas një 100 vite aty, e

me këtë nen për mu ba vitias duhet mi pas 10 vite. Unë mendoj se çdo njeri që është me letra me vendbanim i Vitisë nuk mundë mia mohu të drejtën për bursa as për kurr gjë tjetër.

**z.Ali Bajrami:** Sa i përket propozim rregullores është një rregullore që i ka munguar komunës sonë, për ndarjen e bursave për student të Komunës së Vitisë. Të gjitha ato që janë cekur këtu janë të thirrura në dispozita ligjore, të mbështetura në Ligjin mbi Qeverisje Lokale, unë këtu që e kam nënvizuar atë që e përmendi Visari, jo me polimizuar që 10 vite banorë i Vitisë, mundët dikush tash me ardhur mu bë banor i Vitisë, i plotëson kushtet dhe mund me na marrë bursën, po më duket qëndron kjo dhe nuk ka kurr gjë të keqe. Tjetra, qa është shumë me rëndësi të rritja e anëtarëve të komisionit prej 3 në 5, edhe këtu është bërë një punë e mirë, te caktimi i anëtarëve, është e drejtë e kryetarit që të përcaktoj anëtarët e komisionit, unë mendoj se nuk duhet të kemi paragjykime, se kryetari do ti merr njerëzit të caktuar, duke anashkaluar tjerët, unë mendoj se edhe përfaqësimi partiak do ti përmbush kriteret. Ajo që më ra në sy është gjendja ekonomie, sociale, këtë duhet të kemi shumë parasysh që mos të na bjen ndonjë student që është i aftë për shkak të kushteve financiare të mbetet pa studiuar, tjetra studenti/ja që nuk i ka prindit në jetë vlerësohet me 10 pikë, propozim i imi është, nëse nuk i ka dytë me 10, nëse nuk e ka njërin me 5 pikë, kriteret me aftësi të kufizuara, përpos kriterëve që i ka, unë besoj që vlerësimi shtesë me 10 pikë e krijon një përparësi për këta student me nevoja të veçanta. Diçka tjetër nuk kisha, prandaj propozoj mos të humbim kohë dhe ta miratojmë që të del edhe konkursi për bursa.

**Z. Vebi Rama:** Unë në seancën e kaluar edhe tash po e theksoj, materiali është prua dhe nuk është marrë parasysh asgjë nga vërejtjet që i kam paraqitur, i paraqes edhe sot. Te neni 9, gjegjësisht 10, te kriteret që thuhet, studentët e kategorive të dala nga lufta, në kushte të barabarta të kenë përparësi, unë kisha me than dhe kam than që neni 10 duhet të futët ne nenin 9 dhe në kushte të barabarta, por kategoritë e dala nga lufta duhet të vlerësohen me pikë edhe atë pikë maksimale 30, sepse falë sakrificës së tyre na jemi në këtë Kuvend.

**z.Hasan Aliu:** Visari kur e shtroi pyetjen e meriton me shikua atë, por edhe në aspektin që e shtroi Aliu ndoshta kemi mund me zbut, mos me lënë 10 vite, çështja e debatit e njoftuar ka qenë me kohë, ka qenë në faqe të Komunës, në vende ma të frekuentume, do me thanë se interesimi ka qenë shumë i vogël ajo është çështje tjetër, por megjithatë nuk mund me thanë se ka dështuar debati, dhe se nuk ka pas vërejtje nuk do me than që ka dështuar debati, por ndoshta ju ka pëlqyer kjo rregullore për bursa. Sa i përket anëtarëve i kemi me kërkesë, i kemi bërë nga 3 anëtarë në 5 anëtarë, komisionin e formon Kryetari. Pajtohem që komisioni të jetë heterogjenë, jo një partiak, por megjithatë duhet ta kuptojmë pozitën e këshilltarit komunal dhe shërbyesve civil, këtë dallim duhet ta bëjmë, dhe konkursi i cili do të jetë. Ne e kemi paraparë edhe çështjen e veteranëve veç, aq e kini përzier me veteran që nuk e din edhe kush është, dhe u tha se lista pak ka, jo lista është aq e madhe që edhe Gjilani qa ndan bursa ka veteran Komuna e Vitisë. Pajtohem plotësisht për familjet e dëshmorëve, për invalidët e luftës, por kjo e fundit duhet të shikohet, se ende nuk ka kurr gjë. Çështja të cilën ne nuk merremi sot

me shumë ne merremi me aprovim të rregullores, me shumë do të merret ekzekutivi. Ne dëshirojmë se numri i përfituesve të bursës të jetë i madh dhe dëshiroj që përfitues të bursës të jenë ata që e meritojnë, për këtë po flasë për të gjitha kategoritë që konkurrojnë dhe me të vërtetë të jenë shumë të arsyeshëm edhe para tij që nuk i kemi ndarë, se pakënaqësi kemi me pas. Unë konsideroj se numri do të jetë diku 120 edhe nuk është definitiv, prandaj mos të humbim kohë rrethe çmimit, urdhëroni propozoni ndonjë nen tjetër, nëse ju e aprovoni unë jam për me shtie, por mos të ndalemi te çështjet, se janë të ndjeshme, po kthemi edhe një herë çështjen, se e shtroi Visari edhe një herë po i kthemi, meriton mu debatua me lënë me vite po, por 10 vite po më duket edhe mua shumë, por jo edhe pa kriter.

**z.Visar Demiri:** Nuk e kam has, nuk kam hallin a është 10 vjet, se nuk po më prish punë mu personalisht, jam edhe për ata me marr një i Vitisë, se jemi pak lokalista, por problemi është ligji, qa thotë se nëse një i Ferizajt bëhet banor i joni, atëherë ai mbet pa vendbanim të Ferizajt nuk mund me aplikua më në Ferizaj dhe po mbet si ata personat që janë pa atdhe, se nëse na ja mohojmë të drejtën këtu atje ma nuk mundet, do me thanë mbetët kerkund dhe ka të drejtë të na qes në gjyq, për ata duhet mu konsultua mirë me ligjin.

propozim konkret i imi është me hekë krejt këtë nenë me konsultim me ligjin .

**z.Vehbi Rama:** z.Nënkryetar, po e shohë që thuhet edhe shkruhet se ky Kuvend merr vendime nga një këshilltar, kjo nuk është e vërtetë, po e shohë se nuk po përfillet. Sa i përket veteranëve bërë një pyetje prekëse, se kush nuk e dinë kush është veteran e kush nuk është, unë e di se secili kush donë me dit kush është veteran naltë është lista deri para publikimit, që ka dal në internet, që nuk është kjo e saktë, kjo është fillestare nuk është përfundimtare e përfundimtarja qa është në shoqatë, andaj kërkoj se mu ndryshua neni 10, që mos mu nda mos me bërë përçarje, janë dëshmorë, invalid, por të gjithë si veteran duhet tu jepet bursa.

**z.Hasan Aliu:** Unë nuk e kam të kartë, po më duket Vehbi ti the atë që e thash unë, vetëm me një gjuhë tjetër, në rast se është lista pse u formua komisioni mi vërtetua, a din me më tregua, na mundemi mi dhanë ngjyrim si të dojmë, por realiteti te na është ky, por guximin për me thanë unë e kamë. Tash në vit del lista e verifikuar mirë, ai që u kanë respekt, mi ndihmua, mi dhanë përparësi, se këtë vit i kemi 180 veteran, 50% me pas fëmijë eliminohen kategoritë tjera.

**Kryesuesi:** Unë po konsideroj se kjo çështje mese tha edhe nënkryetari nuk është hala e verifikuar, konsideroj se në vitin e ardhshëm kur të shpërndahen bursat tjera mund ta revitojmë ne këtë rregullore, nuk prish punë kurrëgjë, mirëpo tash po dalim nga ajo se tha Visari, atëherë kush është që të heket neni 3 dhe të mbetet banor i Komunës së Vitisë, ju lutëm me ngritje dore konstatoj se me vota unanime hekët neni 3, ndërsa te viti parë të merret parasysh rezultati i shkollës së mesme, që të vlerësohen me 10 pikë, ju lutëm me ngritje dore.

**z.Bekim Azizi:** Ne do ta marrim parasysh se studentet e kanë pasur një afat të vitit të parë, mund mu kanë studenti prej ma të mirëve, por nuk e ka dhanë asnjë provim. Te studentat që nuk kanë nota të dhëna në vit të parë, duhet ta marrim për bazë shkollën e mesme, patjetër të

poentohet me 10 pikë, dhe fëmijët e dëshmorëve nuk mund mu llogarit me asnjë fëmijë tjetër, ai të hy pa kriter, që ai mos të hy me nenin 10, se neni 10 po na i komplikon këto, por edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, se janë studentë, unë kisha propozua që këta të hynë pa kriter.

**Kryesuesi:** Kush është që të kalojnë këto dy propozime për studentët e vitit të parë, që të merren parasysh notat nga shkolla mesme, të vlerësohen me 10 pikë dhe fëmijët e dëshmorëve, kush është për: konstatoj se me vota unanime u aprovuan këto ndryshime në rregullore, meqenëse u shterr diskutimi rreth kësaj pike, atëherë e hedhim në votim për miratim, kush është që të miratohet kjo rregullore ju lutëm me ngritje dore, konstatoj se me vota të të gjithëve u miratua kjo rregullore

Si pikë të 4 të rendit të ditës kemi

#### **4. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e tregut të gjelbër në Pozheran.**

Ftoj drejtoreshë e gjeodezisë që ta merr fjalën

**znj.Fatbardha Emini:** Përshëndetje i nderuari Nënkryetar, të nderuar Anëtar të Kuvendit Komunal dhe ju të pranishëm! Sot para jush paraqes vendimin për caktimin e lokacionit për vendosjen e tregut të gjelbër në Pozheran. Të nderuar anëtar të kuvendit, siç e dini se Komuna e Vitisë nuk është në gjendje të mirë sa i përket pronës komunale, kështu që për ti paraqitur projektet e saj në mënyrë të vazhdueshme, pikërisht për këtë arsye po hasë në vështirësi, andaj se sot e prurë këtë propozim dhe dëshiroj të kaloj kjo pikë, materialin e keni marr me kohë, për pyetje a për ndonjë sugjerim jam këtu për tu ndihmuar.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtoresh, hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës, a donë dikush të merr fjalën, ju lutëm nëse nuk ka, atëherë e hedhim për miratim. Kush është për, konstatoj se me votat të gjithë të pranishmëve miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

#### **5. Propozim vendimi për dislokimin e tregut të gjelbër në Pozheran.**

**znj.Fatbardha Emini:** Edhe kjo pikë e ka të njëjtën çështje, andaj nuk do tu marr kohë ma shumë, për pyetje a për ndonjë sugjerim jam këtu për tu ndihmuar.

**Kryesuesi:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës, a donë dikush ta merr fjalën, pasi nuk ka të interesuar e hedhim në votim për miratim. Konstatoj se me votat e të gjithë të pranishmëve miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të 6 të rendit të ditës kemi :

#### **6. Propozim vendimi për bashkëfinancimin e projektit: Rregullimi i trotuareve.**

Ftoj drejtorin ta merr fjalën rreth kësaj pike

**z.Ibrahim Rama:** Me këtë propozim vendim është menduar që një projekt që ka kaluar në listën e projekteve kapitale për vitin 2015 e që është miratuar në këtë kuvend ka marr përsipër DEMOS-i, që e kemi fituar këtë grand me financua këtë projekt, por kusht ka qenë projekti dhe na e kemi pasur në listën e projekteve rezervë dhe këtë projekt ata e financojnë 70%, ndërsa Komuna 30%. Materialin e keni para, për pyetje dhe përgjigje jam në dispozicion për ju.

**Kryesuesi:** Faleminderit z.Drejtor, hapim debat rreth kësaj pike, a donë dikush të merr fjalën, nëse nuk ka, atëherë e hedhim në votim, kush është që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të fundit të rendit të ditës kemi:

#### **7. Propozim vendimi për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2014 në vitin 2015**

Ftoj drejtorin që të merre fjalën rreth kësaj pike.

**z.Ibrahim Rama:** Të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Vitisë! Komuna për vitin 2014 ka pasur të hyra të realizuara në shumë prej 961 mijë 016 Euro, nga fondi burimor 876 mijë dhe nda fondi burimor 22,84 mijë 420 euro. Të shpenzuara mjete të vitit 2014 janë 748 mijë, mbetja pa shpenzuar e buxhetit të Komunës për vitin 2014 është shuma 212 mijë e 909 euro, duke u bazuar në Ligjin nr.5/L për buxhetin e Republikës së Kosovës, neni 7, ndarja dhe rindarja e fondeve të ri bartura, kërkojnë nga Kuvendi Komunal, që të aprovoj këtë bartje të mjeteve të të hyrave vetanake në shumë prej 212 mijë 901,19 euro, kjo shpërndarje do të bëhet në këto ku marr kategori, mos tu marr kohë, materialin e keni para jush, kjo do të ishte mirë të aprovohet.

**Kryesuesi:** A don me marr fjalën dikush rreth kësaj pike?

**z.Bekim Azizi:** Besoj ndoshta një sqarim ma jep drejtori, duke u bazuar në raportin që e diskutuam në pikën e parë, te buxheti i pa shpenzuar 265 mijë e 576 euro, ndërsa bartja e buxhetit është 212 mijë euro, tash është një 53 mijë euro, që është një vakum këtu, po kërkoj një sqarim, ku janë shkuar qeto 53 mijë euro.

**z.Ibrahim Rama:** Shumën prej 212 mijë e 901 euro e përmban të hyrat vetanake komplet, të cilat nuk humbin, me pas qenë grand qeveritar sigurisht ato nuk ishin kthyer, por janë të hyra vetanake. Me këto mjete na do ti paguajmë gjithnjë obligimet që i kem trashëguar nga viti 2014 dhe mjetet e bartura në vitin 2015, për mi pagua këto obligime. Vitin 2015 e fillojmë me një total të borxhit prej 99 mijë e 345 Euro, nga kjo shumë 46 414 janë borxhe të vitit 2013 dhe

52 të vitit 2014. Ndërsa, sa i përket pyetjes së Bekës, 50 mijë për rrugën në Remnik dhe 212 i kemi, bëjnë 262 mijë Euro, pra, nga kjo shumë 50 mijë në rrugën e Remnikut.

**Kryesuesi:** Dikush tjetër a donë ta merr fjalën, si duket nuk kemi, e hedhim në miratim, kush është që të miratohet kjo pikë, me 19 vota pro, 3 abstenime, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Para se ta përmbylli, më lejoni se grupi i grave e ka pruar një informatë në lidhje me punën e tyre të cilën e kanë bërë gjatë periudhën 9 mujore, më lejoni ta falënderoj kryetaren e grupit të grave për punën që e ka bërë gjatë këtij viti dhe për hir të korrektësisë kishte qenë mirë që tu japim fjalën në pika të shkurta.

**Znj.Mirlinda Sadiku:** Përkundër asaj se dikujt ju bënë kokëdhimbje, megjithatë grupi i grave të Vitisë, mund me thanë me kompetencë të plotë se ka qenë mjaft i suksesshëm. Mu nuk do të më bërë të suksesshëm po mos të kisha pas përkrahjen e gjithë grupit të grave. Ajo çka më ka bërë mu ndie krenare dhe me të vërtet me pas vullnet me punua ka qenë se përkundër kartelave politike këna arritur me kalua, që me dhanë një kontribut, një punë të përbashkët, do të kisha pasur dëshirë që prapë ta dërgoj mesazhin te Kryetari z.Haliti, që edhe se premtimin kur e ka dhanë mi përkrah nënat, të cilat janë lehona, janë në skemën sociale, ka qenë një kohë e fushatës parazgjedhore, do me thanë fushata që ka qenë në qershor ta mbaj atë premtim dhe me të vërtet kur bëhet buxheti të kihet parasysh këto gra edhe të përkrahën. Tash me mandat të ri është doktoresha Gjylsime Qamili, me një unanimitet e kemi votuar të gjithë dhe i dëshiroj punë të suksesshme.

**Kryesuesi:** Me kaq përmbyllim seancën, mirë u pafshim në seancat tjera të radhës.

Seanca përfundon punimet në ora 14:15 min.

**Procesmbajtës:**

**Ilir Zuka**

-----

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**z.Naim Pira**

-----